



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Nr. 1442/ Prot.

Korçë, më 11.09.2024

Njoftim Për shpalljen e procedurave të konkursit për kandidatë të shërbimit psikosocial.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social", i ndryshuar si dhe sipas shkresës nr 2746 prot dt 11.09.2024 të AKAP Tiranë, hap konkursin për kandidatët e interesuar për shërbimin psikosocial.

1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë (DRAP Korçë) më datë 11.09.2024 shpallin njoftimin e pranimit të dosjeve për kandidatët të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në konkurs për punonjës të shërbimit psikosocial pranë institucioneve arsimore. Shpalljet e vendeve vakante bëhen sipas Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në varësi.
2. Për kandidatët që dëshirojnë të konkurrojnë për tu pranuar në shërbimin psikosocial ju lutem të shikoni vendet vakante bashkëngjitur.

Dosjet dërgohen nëpërmjet shërbimit postar në adresën e DRAP Korçë "Rruga Dhimitër Denasi" Lagja 18 Korçë.

Kushtet Specifike:

I. Kriteret për t'u punësuar në shërbimin psiko-social:

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative, apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse.
3. Njohuri bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).
5. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale – Jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 I ndryshuar (**e detyrueshme**);
2. Kërkesë për (pjesëmarrje në konkurrim) për punësim në **Zyrën Vendore Arsimore** ku dëshirojnë të aplikojnë për për pozicionin psikolog / punonjës social (**e detyrueshme**);
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit (**i detyrueshëm**);
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e Diplomës/diplomave (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (**e detyrueshme**);
5. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (**e detyrueshme**);
6. Leje për ushtrimin individual të profesionit - kopje e njehsuar me origjinalin (**licencë**) (**për kandidatët për psikologë të licencuar në vitin 2019 e në vijim, duhet të disponojnë licencë në psikologji shkollore**);
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga aplikanti sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 I ndryshuar (**e detyrueshme**);
8. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 I ndryshuar (**e detyrueshme**);
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
10. Libreze pune fotokopje e noterizuar nëse ka;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e tre muajve të fundit (**e detyrueshme**);
12. Dëshmi penaliteti (**e detyrueshme**);
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (**detyrueshme**).

B. KUJDES!!! Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara. Nëse në dosjen e aplikimit mungon një nga dokumentat e detyrueshme atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.

C. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Korçë, për të gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim në ZVAP-et në varësi të DRAP Korçë, përkatëse brenda afatit **11.09.2024-16.09.2024**

III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social të paraqitur në dosje, do të kryhet nga komisioni në periudhën 16.09.2024-18.09.2024

- Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në këndin e njohimeve të institucionit arsimor dhe në faqet zyrtare të ZVAP-ve dhe DRAP Korçë në datë 18.09.2024 ;
- Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Korçë (DRAPKorce@arsimi.gov.al) brenda datës 21.09.2024 .

- Shpallja e listës përfundimtare e kandidatëve që kalojnë fazën e parë brenda datës 23.09.2024 .
- Brenda datës 23.09.2024 DRAP Korçë, njofton nëpërmjet faqes zyrtare lidhur me mjedisin, vendin dhe orën e zhvillimit të testimit.

IV. Testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit, për kandidatët që kanë kaluar vlerësimin me dosje, do të zhvillohet në datën 24.09.2024

- Vlerësimi i testeve dhe shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar me pikët e dosjes dhe testit do të bëhet në datë 25.09.2024

V. DRAP Korçë me një njoftim në faqet zyrtare, do të shpallë listën e kandidatëve të kualifikuar dhe grafikun e intervistave të strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim, duke filluar nga data 26.09.2024-27.09.2024.

VI. Në përfundim të intervistës, komisioni ad-hoc shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës-social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej, (pikët e dosjes + pikët e testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen e institucionit brenda datës 30.09.2024.

VINJOLA ROTA

DREJTOR

